




” Alb Audit ” Sh.P.K.



Kompania “ Bifurkacioni ” Sh.A.

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyrat Financiare

31 Dhjetor 2021

Përmbajtja

-Raporti i auditorit të pavarur	3- 7
-Informata të përgjithshme mbi biznesin.....	8
-Adoptimi i standardeve-SNRF.....	10- 12
-Pasqyrat financiare.....	13- 19
-Pasqyra e politikave kontabël dhe shpalosjet.....	20- 26
-Vleresimet kritike, shtrirja e auditimit dhe përfundimi.....	27- 30

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Ndërmarrjes "Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj

Opinioni i Kualifikuar i Auditorit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Kompanisë Rajonale të Ujit "Bifurkacioni" Sh.A. që përfshinë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale të pozicioneve financiare të shqërisë aksionare Kompania Rajonale e Ujit "Bifurkacioni" Sh.A. më datë 31 dhjetor të vitit 2021, përveç pozicioneve të cilat janë theksuar në "Bazen për Opinion" të cilat kanë ndikuar në "Koalifikimin e Opinionit". Kjo përfshinë rezultatet e operacioneve të saj, pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrës së rrjedhës së parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet për përdhën e përfunduar, në pajtueshmëri me Standardet Nderkombëtare të Kontabilitetit(SNK) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar(SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimit e bërë. Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga shoqëria në përputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Konsiderojmë se janë bërë hapa dhe veprime të nevojshme lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i periudhës së kaluar dhe opinionin i auditimit është modifikuar por është i kualifikuar për shkak të çështjeve të theksuara të cilat konsiderojmë se kanë ndikuar në pozitën financiare dhe performancën e kompanisë për vitin i cili përfundon më 31.12.2021 dhe se keto mangësi akoma nuk janë eliminuar plotësisht.

Jemi të mendimit se është me ndikim në prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare nëse konstatojmë se është e nevojshme dhe e dobishme të theksojmë çështjet në vijim si përkujtim menaxhmentit për veprim të nevojshëm për përmirsim procesi për kompani dhe atë:

Sistemimi, Emërtimi&Vlerësimi i Aseteve- Gjetje#1

Vlera e tërësishme neto e asetëve në evidencat kontabël- pasqyra financiare të prezantuara në fund të periudhës 2021 ishte 6,021,256.00Eu. Këto pasuri ishin prezantuar në gjashtë grupe të mëdha si Toka, Objektet Ndërtimore, Rrjeti i Kanalizimit, Rrjeti i Ujësjellësit, Donacioni Qeveri&Donacioni Zvicër me gjithsej vlerë neto 5,981,270.49Eu. si dhe gjashtë pozicione të vogla me gjithsej vlerë neto prej 39,985.79Eu.

Emertimim i mjeteve themelore- asetëve afatgjata në evidenca kontabel si dhe në shpalpsjet e grupeve të mjeteve themelore nuk ishte bërë sipas kriterëve dhe kërkesave profesionale. Grupi i asetëve të

emertuara si "Donacioni i Qeverise"&"Donacioni Zviceran" si grup i "Mjeteve Themelore" nuk perkon funksionin te cilat kryejne keto aset si dhe me kerkesat profesionale te udheheqjes se ketyre pasurive ne evidenca kontabel dhe as ne prezantim te tyre ne shpalosje. Keto vlera kontabel pasiqe te jene realizuar punet e caktuara dhe te jene aktivizuar ne proces te operimit nuk jane bashkangjitur grupit te aseteteve ku edhe realisht kryejne funksionin e tyre. Po ashtu kemi hasur ne emertime si "Punime toksore" "Investime kapitale nga Qeveria" etj.

Emertimi i aseteteve si "Donacion" ka ndikuar qe vlera e grupeve te caktuara te aseteteve te mos jete e prezantuar sakte ne pasqyra fionanciare.

Rekomandojme menaxhmentin te beje sistemimin adekuat te vlerave te aseteteve te paraqitura ne evidenca kontabel dhe pasqyra si "Donacion" ne grupe te mjeteve ku ato praktikisht jane implementuar dhe sistemuar si ne "Rrjet Kanalizimi", "Rrjet Ujesjellesi" "Ndertesa" etj. Donacionet, grantet dhe subvencionet kerkohet te mbahen ne evidenca te veqanta, ndersa kur kalohet ne implementim do ti ngjten grupit te caktuar per te cilin jane destinuar.

Ne evidenca kontabel te pasurive afatgjata udhehiqen nje numer i madhe i pasurive- invetnare e vegla pune te cilat realisht eshte dashur te udhehiqen ne inventare dhe te shpenzohen ne periudhe. Keto inventare e vegla jane zhvleresuar sipas normave te ndryshme.

Nuk kemi mund te hasim ne evidenca kontabel te udhehiqet pozicion analitik "Shtasat per periudhe" ku pasqyrohen shtesat- respektivisht investimet kapitale gjate periudhes ne secilin aset te veqant.

Çështja e rivlerësimit të aseteteve sipas standardeve nderkombetare te kontabilitetit SNK- 16 duhen kryer ne menyre te rregullt qdo tre deri ne pese vite me qellim te sigurimit se vlera kontabel e aseteteve eshte ne harmoni me shfrytezimin e asetit ne periudhe.

Procesi i vleresimit te aseteteve ne KRUB per here te fundit ishte kryer ne vitin 2007 nga nje kompani e huaj. Ndonese sipas legjislacionit ne fuqi te Republikes se Kosoves eshte njohur institucioni i vlersuesit te pavarur te aseteteve kompania nuk ka kryer nje aktivitet te tille nga viti 2007. Ne libra kontabel evidentohen nje sasi e madhe e aseteteve te cilat jene ne perdorim me vlere zero. Ndonese jeta e tyre e dobishme ka perfunduar per qeshtje tatimore, ato edhe sot krijojne te ardhura. Kpnsiderojme se vlera e tyre nuk eshte e sakte respektivisht eshte e nenvleresuar.

Moskryerja e procesit te rivleresimit te pasurive- aseteteve te kompanise nga regjistrat kontabel ndikon ne paraqitjen jo te sakte te vleres se aseteteve te kompanise dhe ne paraqitjen jo te sakte te pasqyres se pozites financiare te kompanise.

Rekomandojme menaxhmentin e kompanise qe ne varesi nga kapacitetet te kryej vleresimin e aseteteve ne harmoni me kerkesa profesionale dhe ligjore.

Inventarizimi i rregullt i pasurive dhe detyrimeve- Gjetje#2

Bazuar ne nenin 12 të ligjit 06/L-032 për kontabilitet, auditim dhe raportim financiar, shoqëritë tregtare, subjekte të këtij ligji, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i aseteteve dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues te shoqëritë tregtare, duke perfshirë në menyre të përgjithshme të gjitha pozicionet nga librat kontabel si dhe pasuritë të cilat eventualisht nuk janë të përfshira në libra kontabel.

Po ashtu kompania regjionale e ujit "Bifurkacioni" ka hartuar dhe aprovuar udhezues te procedurave dhe politikave kontabel me nr.1877 të dt.13.11.2020 i cili parasheh edhe regjistrimin- inventarizimin e pasurive(ne udhezim thuhet depos- stoqeve). Kemi konstatuar se udhezimi si i tille parasheh ne faqen 10 kete process. Udhezuesit te pjesa e inventarizimit i mungon pershkrimi i aktiviteteteve te cilat duhet zhvilluar me rastin e inventarizimit dhe ate:

- Nuk parasheh regjistrimin-inventarizimin e pasurive dhe detyrimeve sipas gjendjes ne pasqyren e pozicionit financiar te kompanise ne ditën e bilancit, por vetem stoqet e depone.
- Nuk parasheh procedurat nga vendimi per emerimin e komisioneve dhe procedurat te cilat duhet te zhvillojne komisionet per regjistrim- inventarizim siq eshte hartimi i planit dinamik te punes, regjistrimi fizik, harmonizimi- konstatimi i mungesave dhe tepricave, perpilimi- aprovimi i raportit dhe azhurnimet e mungesave/tepricave- regjistrimet e nevojshme ne kontabilitet.

Gjate zhvillimit te procesit te auditimit ne nuk mundem te bindemi ne ekzistencen dhe zhvillimin e procedurave lidhur me inventarizimin. Perpos rgjistrave ku ishte prezantuar ekzistenca fizike e pasurive, veprime tjera nuk mundem te konstatojme te ishin kryer- si harmonizimi me evidence kontabel, perpilim i raportit- elaboratit ku do prezantohen tepricat e mungesat te cilat organi kompetent metutje i aprovon per implementim. Po ashtu ka ndodhur qe ne komisione per regjistrim te jane vendosur anetare nga sherbimi llogaridhenes.

Kryerja e procesit te inventarizimit me procedura jo te plota ndikon ne efektivitetin jo te plote te ketij procesi si dhe ne prezantimin e plote dhe te sakte te ketyre pasurive dhe detyrimeve. Pjesemarrja e zyrtareve nga sherbimi financiar ne kryerjen e punëve të inventarizimit mund të sjell në konflikt çëshjen e llogaridhënies, dhe mund ta merr kuptimin e harmonizimit dhe barazimit të llogarive në të cilat anëtari i komisionit është në proces të krijimit dhe mbajtjes së tyre.

Rekomandojme menaxhmentin e kompanise qe procesi i inventarizimit te kryhet sipas kerkesave prfesionale dhe ligjore. Po ashtu rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që zyrtarët nga sherbimi financiar- kontabel ku krijohen dhe mirembahen evidencat kontabel të mos përfshihen në komisione të regjistrimit.

Gjendja e llogarive te arketueshme- Gjetje #3

Nga pasqyra e pozicionit financiar të kompanisë rezulton të jenë prezantuar pasuritë qarkulluese si llogari të arketueshme në vlerë 8,967,677.00Eu, gjegjësisht në vlerë neto 5,978,098.00Eu. kur zbriten "borgjet e ngrira të dyshimta" siq janë emërtuar në vlerë prej 2,989,579.00, të cilat janë perlllogaritur më metoda sintetike dhe nuk bazohen në perlllogaritje profesionale dhe ligjore. Ka vazhduar rritja e gjendjes se llogarive të arkëtueshme nga viti 2019 në 2020 me 5.1% dhe viti 2021 krahasuar me vitin 2020 me 3.76%.

Kemi analizuar 67 mostra në tri vite në vlerë prej 63,698.91 lëvizjen e gjendjes se ketyra klienteve, duke konstatuar gjendjen jo reale e kërkesave nga klientët- llogaritë e arkëtueshme të cilat nuk janë prezantuar drejtë në pasqyra financiare. Nga analiza e këtyra klienteve kemi konstatuar se pjesa me e madhe e ketij borgji është nga periudhat e kaluara dhe këto kërkesa nuk duhet të prezantohen në pasqyra financiare, në fakt është një prezantim jo i drejtë(shumë i fryer dhe fiktiv) i pasurive qarkulluese.

Mungesa e korigjimeve të nevojshme ka ndikuar që vlera e llogarive të arkëtueshme të prezantohet në mënyre të pasaktë dhe jo të drejtë, respektivisht të paraqesë nje pasuri me tepër fictive të këtyre llogarive në pasqyrën e pozitës financiare të kompanisë.

Rekomandojmë menaxhmentin të bejë rregullimet e nevojshme dhe të menjanoj të gjitha ato llogari të cilat per momentin paraqesin pasuri fictive në konton llogarive të arkëtueshme. Keto llogari duhet dhe mund të mbahen si llogari të veqanta jashtëbilancore, asesi të shlyhen apo të propozohet shlyerje, por të vazhdohet me perpjekje gjithëpërfshirëse për arkëtimin e tyre.

Falja e borgjeve- Gjetje#4

Borgjet e këqija sipas dispozitave ligjore në fuqi në Kosovë, trajtohen në ligjin nr. 03/L-162 mbi tatimin në të ardhura të Korporatave. Neni 12, pika 1,2,3,4 trajton borxhin e keq dhe atë pasi të jenë shterur të gjitha rrugët ligjore, duke filluar nga letër kujtesa deri tek rrugët gjyqësore(kushti kryesor i realizimit më konkret i nenit 12 të këtij ligji përshkruhet në udhëzimin administrative 14/2010, gjegjësisht nenin 10 të këtij udhëzuesi ku thuhet: "Për qëllime tatimore shpenzimi për borgjin e keq nuk mund të bazohet në llogari të përkohshme. Duhet bërë rregullime në librat e tatimpaguesit për të pasqyruar shpenzimin actual të borgjit të keq, duke u bazuar në ato borgje të veçanta të cilat i plotësojnë kushtet për të qenë shpenzime(d.m.th. një borgji duhet të jetë 6 muaj i vjetër dhe të ketë prova të mjaftueshme të përpjekjeve të pasukseshme për të vjelë borgjin).

Po ashtu ligji 03/L-146 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar, gjegjësisht neni 43 pika 1 trajton çështjen e borgjit të keq për qëllime të TVSh-së ku thuhet: "Kur pagesa e tërësishme apo një pjesë e saj për furnizimin(shitjen) e tatueshëm, nuk është pranuar nga personi i tatueshëm(furnizuesi-shitësi), ai mund të konsideroj shumë e papaguar(pa arkëtuar) si për qëllime të TVSH-së". E tërë kjo e derjtë në TVSh(si pasuri e kthyeshme) nga borgji i keq për qëllime të TVSh-së sipas ligjit 03/L-146, do të njihet nga ATK. duke u adresuar me kërkesë të mbështetur në dëshmi të vlefshme.

Ligji 05/L- 043 për faljen e borgjeve publike, përcakton menyren e realizimit të procesit të faljes së borgjeve publike. Neni 43 i këtij ligji përshkruan se si dhe kur institucioni bugjetor apo kompania publike është e obliguar të bëjë shlyerjen e një borgji public. Neni 6 paragrafi 3 i këtij ligji parasheh, nëse personat të cilët perfitojnë nga ky ligj deshtojnë të respektojnë kushtet e kontrates- marreveshjes së firmosur, atëherë kompania publike është e obliguar ta vendosë në regjistrin e borgjlive duke i perlllogaritur të gjitha borgjet e mbetura të cilat kanë figuruar para lidhjes së marreveshjes për falje.

Nga evidenca e kontratave për falje sipas ligjit, nga gjithsej 2,400 kontrata të arritura me klient në kemi perzgjedhur gjithsej 36 raste në vlerë prej 11,988.62. Nga analiza e kryer kemi konstatuar se mbi 50% e kontratave nuk janë përmbushur. Nuk kemi mund të vërejmë se rastet e mospërmbushjes së kontrates të jenë proceduar.

Mungesa e veprimeve të nevojshme ka kontribuar në mosimplementimin e kontratave.

Rekomandojmë menaxhmentin në vazhdimin e përpjekjeve për arketimin e borgjeve të vjetra përmes metodave të ndryshme të aplikueshme dhe praktike

Çështjet Kryesore të Auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF- të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të gabimit apo mashtrimit. Kjo nenkupton zbatimin e standardeve, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi lidhur me kontrollete e brendshme.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësitë e shoqërisë (kompanisë) për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se kur drejtimi synon ta likuj biznesin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër. Të ngarkuarit me qeverisjen e kompanisë janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të biznesit.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Përgjegjësia e audituesit të pavarur

Objektivat tona gjatë auditimit janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshinë opinion tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoj gjithmonë një anomali materiale kur ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, pritet në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

" Alb Audit " Sh.P.K.
Rimzi Jashari, Auditor Ligjor

rr. Fehmi Lladrovci nr.2, Ferizaj
Prill, 2022



1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A. -Ferizaj është ndërmarrje publike regjionale sipas vendimit 09/34 të datës 07.10.2020 që ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujërave të zeza në pjesën jug-lindore të Kosovës në komunën e Ferizajit. Nga viti 1999 kompania i është nënshtruar procesit të konsolidimit deri më 31 Qershor 2007 kur është themeluar si shoqëri aksionare nga Qeveria e Kosovës gjegjësisht Ministria Për Tregëti dhe Industri si ndërmarrje publike lokale dhe aksionar është komuna e Ferizajit me 85.30% të aksioneve dhe me 14.70% komuna e Kaçanikut. Deri në qershor 2008 kompania është mbikëqyrur nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, ndërsa pas kësaj date Kompania mbikqyret nga Komuna e Ferizajit si kompani lokale gjegjësisht edhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Nga fundi i vitit 2020 kompania ka ndërruar stsus dhe tani është kompani publike qendrore. Kompania posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së saj, lëshuar nga Zyra Rregullatore për ujë dhe Kanalizim. Prodhimi dhe shitja e ujit të pijshëm, mbledhja e ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike janë aktivitetet kryesore të kompanisë. Vlerat kryesore të kompanisë janë përkushtimi për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve, arritja e vetëqëndrueshmërisë financiare dhe të qenit transparent ndaj akterëve relevant të sektorit të ujit në Kosovë. Kompania posedon NUI- 810663353, certifikatë të numrit fiskal 600027892, certifikatën e numrit të regjistrimit të biznesit:70433592 dhe certifikatën e TVSH-ës me numër: 330035859. Adresa e zyrës qendrore është rruga "Enver Topalli" nr.42A në Ferizaj. Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25,000.00 Euro. Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A. Ferizaj ka edhe njësit e saja: Njësia Operative "Bifurkacioni" në Kaçanik dhe Zyra e Shërbimeve ne Han te Elezit.

Qasja ne te dhenat e kompanise(bazat) është e rregulluar sipas kierarkisë dhe në të dhëna kanë qasje vetëm personat e autorizuar.

Entiteti kujdeset për mbrojtjen në punë të punëtorëve, mjedisit dhe klientëve duke respektuar ligjin dhe standardet të cilat rregullojnë këtë fushë.

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Jeton	Shabani	Drejtor menaxhues	Sipas ligjit dhe statutit.

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Qeveria e Kosovës	25,000.00€	100.00%

Njësitë

Nr	Numri i njëseisë	Emri	Vendi
1	810271479	Njesia Operative Kaçanik	Kaçanik, Kaçanik
2	810271487	Zyra Shërbimeve Hani Elezit	Hani i Elezit, Hani i Elezit

Aktivitet/et

Kodi	Përshkrimi	Tipi
3600	Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë	Primarë
4313	Testi i shpuarjes dhe shpuarja	Sekondarë
4322	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit	Tjera
4399	Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t.	Tjera

Kodi	Përshkrimi	Tipi
4671	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to	Tjera
4675	Tregtia me shumicë e produkteve kimike	Tjera
4941	Transporti rrugor i mallrave	Tjera
4950	Transporti përmes tubacioneve	Tjera
5040	Transporti i brendshëm ujqor i mallrave	Tjera
5210	Magazinimi dhe ruajtja	Tjera
5222	Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin ujqor	Tjera
5829	Publikimi i softuerëve të tjerë	Tjera
6820	Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira	Tjera
7112	Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik	Tjera
7120	Testimi teknik dhe analizat	Tjera
7732	Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve të ndërtimtarisë dhe inxhinierisë	Tjera
7734	Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e pajisjeve të transportit ujqor	Tjera
8299	Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t.	Tjera
8411	Aktivitetet e përgjithshme të administratës publike	Tjera
9329	Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit	Tjera
9609	Aktivitetet e tjera p.k.t.	Tjera
3530	Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar	Tjera
3700	Kanalizimi	Tjera
4291	Ndërtimi i projekteve të ujit	Tjera

KRUB- Sh.A. për pasuritë e saja, detyrimet dhe aktivitetet afariste mban kontabilitet sipas kërkesave të rregulloreve e ligjeve në fuqi. Gjithashtu, ndërmarrja përgatitë edhe pasqyrat financiare dhe raportin në harmoni me standardet e kontabilitetit të cilat aplikohen në Kosovë.

Burimet e të ardhurave të kompanisë janë aktivitetet afariste fitimprurëse të bazuara në rregullore dhe akte të themelimit.

Kompania për periudhën e raportuar të aktivitetit si dhe vitet e mëparshme raportuese të aktivitetit të saj ka realizuar rezultate të cilët janë paraqitur në pasqyrat e saj financiare, të cilat pas llogaritjes dhe pagesës së tatimit janë sistemuar sipas ligjit.

Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara

- Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën e tanishme:

- **SNK 8 - Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet** - SNK 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet" është aplikuar në zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit, kontabilizimin e ndryshimeve në vlerësime dhe pasqyrimin e korigjimeve të gabimeve të periudhës së mëparshme. Standardi kërkon pajtueshmëri me çdo SNRF specifike që zbatohet për një transaksion, ngjarje ose kusht dhe ofron udhëzime për zhvillimin e politikave të kontabilitetit për zërat e tjerë që rezultojnë në informacione të rëndësishme dhe të besueshme. Ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe korigjimet e gabimeve zakonisht llogariten në mënyrë retrospektive, ndërsa ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit zakonisht llogariten në bazë të perspektivës. (Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNK 39 - Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja** - SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" përshkruan kërkesat për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, pasiveve financiare dhe disa kontratave për të blerë ose shitur artikuj jo-financiarë. Instrumentet financiare njihen fillimisht kur një njësi ekonomike bëhet palë në provizionet kontraktuale të këtij instrumenti dhe klasifikohen në kategori të ndryshme në varësi të llojit të instrumentit, i cili më pas përcakton matjen pasuese të instrumentit (zakonisht kostoja e amortizuar ose vlera e drejtë). Rregulla të veçanta zbatohen për derivativët e përfshirë dhe instrumente mbrojtëse. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi i më hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020.)
- **SNRF 4 - Kontratat e Sigurimit [zëvendësohen]** - SNRF 4 "Kontrata e Sigurimit" zbatohet, me përjashtime të kufizuara, për të gjitha kontratat e sigurimit (përfshirë kontratat e risigurimit) që një njësi ekonomike lëshon dhe për kontratat e risigurimit që ajo mban. Në dritën e projektit gjithëpërfshirës të IASB mbi kontratat e sigurimit, standardi siguron një përjashtim të përkohshëm nga kërkesat e disa SNRF-ve të tjera, përfshirë kërkesën për të marrë parasysh SNK 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet" kur zgjedhin politikat e kontabilitetit për kontratat e sigurimit. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi më i hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNRF 7 - Instrumentet Financiare: Shpalosjet** - SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese" kërkon dhëniën e informacionit në lidhje me rëndësinë e instrumenteve financiare të një njësie ekonomike, natyrën dhe shtrirjen e risqeve që vijnë nga instrumentat financiarë, si në aspektin cilësor dhe sasior. Kërkohen shpalosje specifike në lidhje me aktivet financiare të transferuara dhe një numër çështjesh të tjera. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi më i hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNRF 9 - Instrumentet Financiarë** - Versioni përfundimtar i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" të lëshuar në Korrik 2014 është zëvendësimi i IASB i SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja". Standardi përfshin kërkesat për njohjen dhe matjen, zhvlerësimin, çregjistrimin dhe kontabilitetin e përgjithshëm mbrojtës. (Në fuqi nga 1 janari

2011, lejohet aplikimi i më hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)

- **SNRF 16 – Qiratë** - SNRF 16 specifikon mënyrën e njohjes, matjes, paraqitjes dhe zbulimit të qirave. Standardi siguron një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit, që kërkon njohjen e aktiveve dhe pasiveve për të gjitha qiratë, përveç nëse afati i qirasë është 12 muaj ose më pak ose aktivi bazë ka një vlerë të ulët. Kontabiliteti i qiradhënësit gjithsesi mbetet kryesisht i pandryshuar nga SNK 17 dhe ruhet dallimi midis qirave operative dhe financiare. (Në fuqi nga 1 janari 2019, lejohet aplikimi i më hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi i më hershëm.)
- **SNK 1 - Prezantimi e Pasqyrave Financiare** - SKN1 përcakton kërkesat e përgjithshme për prezantimin e pasqyrave financiare duke përfshirë: si duhet të strukturohen, kërkesat minimale për përmbajtjen si dhe konceptet themelore si vijimësia, kontabiliteti në baza akruale dhe dallimet në mes të pasurive/detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata.
- Standardi kërkon që një seri e plotë e pasqyrave financiare të përmbajë një pasqyrë të pozicionit financiar, një pasqyrë të fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, një pasqyrë të ndryshimeve në kapital dhe një pasqyrë të flukseve të parave. (Në fuqi nga 1 janari 2011, lejohet aplikimi më i hershëm. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023. Lejohet aplikimi më i hershëm.)
- **SNK 16 - Aktivët afatgjata materiale** - SNK 16 "Pronë, bimë dhe pajisje" përshkruan trajtimin kontabël për shumicën e llojeve të aktiveve afatgjata materiale. Prona, impiantet dhe pajisjet fillimisht maten me koston e tyre, më pas maten ose duke përdorur një model të koston ose rivlerësimit, dhe amortizohen në mënyrë që shuma e saj e amortizueshme të alokohet në një bazë sistematike gjatë jetës së saj të dobishme. (Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNK 37 - Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara** - SNK 37 "Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara" përshkruan kontabilizimin e dispozitave së bashku me aktivët e kushtëzuara (asetet e mundshme) dhe detyrimeve kontigjente (obligimet e mundshme dhe detyrimet aktuale që nuk janë të mundshme ose nuk maten me besueshmëri). (Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNRF 1 - Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar** - SNRF 1 "Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" përcakton procedurat që një njësi ekonomike duhet të ndjekë kur miraton SNRF-të për herë të parë si bazë për përgatitjen e pasqyrave të saj financiare të qëllimit të përgjithshëm. SNRF-të jep përjashtime të kufizuara nga kërkesa e përgjithshme për të qenë në përputhje me secilin SNRF efektive në fund të periudhës së tij të parë të raportimit të SNRF-ve. (Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNRF 3 - Kombinimet e Biznesit** - SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" përshkruan kontabilitetin kur një blerës merr kontrollin e një biznesi (p.sh. një blerje ose bashkim). Kombinime të tilla biznesi llogariten duke përdorur 'metodën e blerjes', e cila zakonisht kërkon aktive të blera dhe pasivet e supozuara të maten me vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes.

(Efektive për pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore në lidhje me vitet fiskale që fillojnë me ose pas 1 janarit 2011, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i hershëm lejohet nëse një njësi ekonomike zbaton gjithashtu të gjitha referencat e tjera të azhurnuara (botuar së bashku me Kornizën Konceptuale të azhurnuar) në të njëjtën kohë ose më herët.)

- **SNRF 17 - Kontratat e Sigurimit** - SNRF 17 përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe zbulimin e kontratave të sigurimit brenda fushës së standardit. Objektivi i SNRF 17 është të sigurojë që një njësi ekonomike ofron informacione përkatëse që përfaqësojnë me besnikëri ato kontrata. Ky informacion jep një bazë për përdoruesit e pasqyrave financiare për të vlerësuar efektin që kanë kontratat e sigurimit në pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancën financiare dhe flukset e parave. (IASB vendosi me kusht që të shtyjë datën efektive të SNRF 17, Kontratat e Sigurimit në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022. [IASB ka publikuar gjithashtu 'Zgjatjen e Përrjashtimit të Përkohshëm nga Zbatimi i SNRF 9 (Ndryshimet në SNRF 4)' për të shtyrë datën fikse të skadimit të ndryshimit edhe për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023.]

Biznesi parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.

Bilanci i gjendjes së KRU Bifurkacioni ShA Ferizaj më 31.12.2021

	shënimi	31.12.2021	31.12.2020
		në euro	në euro
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	5	429,552	297,694
Llogaritë e arkëtueshme	6	8,967,677	8,524,901
Parapagimet /avanset e paguara		2,339	4,292
Parapagimet / akontacionet	7	-	-
Kërkesat nga ATK - tatimi paradhenje	8		-
Stoqet		243,193	190,464
Borxhet e ngrira te dyshimta		(2,989,579)	(3,005,252)
Gjithsejt pasuritë afatshkurtra		6,653,182	6,012,100
Pasuritë afatgjata			
Prona , paisjet dhe impiantet Pasuritë tjera afatgjate	9	6,021,256	7,135,757
Gjithsejt pasuritë afatgjata		6,021,256	7,135,757
GJITHSEJT PASURITË		12,674,438	13,147,857
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
oblig.per financimin e kontrates	10		
Llogaritë e pagueshme	11	48,341	60,297
Obligimi per pagat netto	12		
Tatimi në fitim , I pagueshëm	14	16,539	37,605
Obligimi per pagese TVSH	14 a		
Obligimi per tatime dhe kontribute	13	27,654	24,884


Detyrime tjera afatshkurte (parapagimet)	28,664	27,449
Gjithsejt detyrimet afatshkurtra	121,198	150,235
Detyrimet afatgjata		
Kreditë dhe huatë , pjesa afatgjate		
Detyrime tjera afatgjate	2,763,521	3,035,740
Gjithsejt detyrimet afatgjata		
GJITHSEJT DETYRIMET	2,884,719	3,185,975
EKUITETI		
Kapitali aksionar	25,000	25,000
Fitimet apo Humbjet e mbajtura	(961,341)	(733,804)
Fitimi apo humbja e vitit afarist	83,516	28,142
Rezervat e tjera	10,642,545	10,642,545
GJITHSEJT EKUITETI	9,789,720	9,961,883
GJITHSEJT EKUITETI DHE DETYRIMET	12,674,438	13,147,857

Kontabilisti i certifikuar

 Nazif Ahmeti

u.d.Zyrtar Kryesor i Financave

 Mentor Ugrmajli

u.d.Kryeshefi Ekzekutiv

 Nazif Asllani

Pasqyra e të ardhurave për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021

	shenimi	31.12.2021	31.12.2020
		në euro	në euro
Të hyrat	16	2,182,196	2,470,092
Të hyrat		316,660	
Të hyrat dnacionit per privilionimitn e II/a			
Te hyrat nga rivlersimi I pasuris		-	
Kostoja e shitjes	17	(46,610)	(43,941)
Fitimi / humbja bruto	18	2,452,246	2,426,151
Të ardhura tjera			
Shpenzimet operative	19 a	217,632	207,471
Shpenzimet pagave te jashtezakonshme		-	24,060
Shpenzimet administrative	19 b	80,780	89,465
Shpenzimet e personelit	19 c	1,170,013	1,169,122
Shpenzimet e zhvlerësimit	19 d	864,863	869,992
Shpenzimet e zhvlerësimit te rivlersimit Shpenzimet e provlionimt II/a nga donaci		-	
Shpenzime tjera	19 e	9,650	31,370
Gjithsejt shpenzimet e vitit		2,342,938	2,391,480
Fitimi / Humbja operative para tatimit SNRF	20	109,308	34,671
Shpenzime te palejueshme - Zhvlersimi për ATK	21		
Te ardhura financiare			31,076

		21,771	
Shpenzime financiare			
Fitimi / humbja para tatimit , para tatimit ATK	22	131,080	65,747
Shpenzimet e tatimit në fitim	23	47,563	37,605
Fitimi / humbja e vitit		83,516	28,142
FITIMI NETTO PAS TATIMIT - SNRF		83,516	28,142
FITIMI NETTO PAS TATIMIT - ATK		83,516	28,142

Kontabilist certifikuar



u.d.Zyrtar Kryesor i Financave

Mentor Ugzmajli

u.d.Kryeshefi Ekzekutiv

Nazif Asllani

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon 31.12.2021

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsejt
Gjendja më 1 janar 2020	25,000	(2,462,175)	-	(2,437,175)
Fitimi / humbja e vitit Dividendat		28,142		28,142
Korigjimi i grantit te shtyre		1,728,371		1,728,371
Rezerva e Rivlersimit dhe rezervat tjera			10,642,545	10,642,545
Gjendja me 31 dhjetor 2020	25,000	(705,662)		9,961,883
Gjendja me 1 janar 2021	25,000	(705,662)	10,642,545	9,961,883
Fitimi / humbja e vitit Diferencat nga regjistrimet stokut ndervite Dividendat		83,516 2,852		83,516 2,852
Rregullimi i asetëve (ulje e ZH/A) ZKA Ndarja e rezervave		(258,531)		(258,531)
Gjendja me 31 dhjetor 2020	25,000	(877,825)	10,642,545	9,789,720

Kontabilist i certifikuar
Hafiz Ahmeti
044/116-067
FERIZAJ

u.d.Zyrtar Kryesor i Financave
Mentor Ugrinajli

u.d.Kryeshefi Ekzekutiv
Nazif Asllani

01.01.2021-31.12.2021

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme
për vitin që përfundon më 31.12.2021**

	shënimi	31.12.2021 në euro	31.12.2020 në euro
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) e vitit		83,516	28,142
Zhvlerësimi i pronës , paisjeve dhe impianteve NDRYSHIMI I PRONES NGA GRANDI NDRYSHIMI I VLERES SE PRONES INVESTUESE Fitimi / (humbja) nga shitja e pronës Shpenzimet e tatimit në fitim		864,863	869,592
(Rritja) / zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(458,448)	(179,940)
(Rritja) / zvogëlimi në stocqe		(52,729)	(23)
(Rritja) / zvogëllimi në pasuritë tjera - parapagime Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë depo		1,953	(27,627)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		(11,956)	(50,286)
DIFERENCA E REZERVAT E RIVLESIMIT		2,852	
Rritja / (zvogëlimi) në detyrime të tjera		(289,300)	(385,909)
Rritja / (zvogëlimi) Tatimi i paguar Interesi i paguar			37,605
Rrjedha neto e parasë nga Aktivitetet Operative		140,751	264,506
Rrjedha e parasë nga Aktivitetet Investuese			
Pagesat për blerjen e pronës , paisjeve dhe impianteve Arkëtimet nga shitja e pronës , paisjeve dhe impianteve Pagesat për blerjen e e pasurive të paprekshme Interesi i arkëtuar Dividendat e arkëtuara		(8,894)	(21,670)
Rrjedha neto e parasë nga Aktivitetet Investuese		(8,894)	(21,660)
Rrjedha neto e parasë nga Aktivitetet Financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë			

Fitimet e mbajtura		
Dividendat e paguara	-	
Arkëtimet per financimin e kontrates nga partneri konzorciumit	-	
Ripagimi i kredive dhe huave		
Pagesat e lizingut financiar		(314,231)
Rrjedha neto e parasë nga Aktivitetet Financuese	-	(314,231)
Rrjedha / (zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	131,858	71,385
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	297,694	369,089
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	429,552	297,694



u.d.Zyrtar Kryesor i Financave

Mentor Uqzmaçli

u.d.Kryeshefi Ekzekutiv

Nazif Asllani

2.PASQYRA E POLITIKAVE TË RENDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1.Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri me ligjet dhe udhëzuesit dhe rregullat për zbatimin e tyre, të cilat janë të aprovuara nga organet relevante, si dhe rregullat e standardet tjera të aplikueshme në Kosovë.

2.2.Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të kontabilitetit, Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar, Ligjin për Kontabilitet Raportim Financiar dhe Auditim, dispozitave tjera ligjore kombëtare që interferojnë në zëra të caktuar të Pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare janë përgatitur nën marrëveshjen e kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara sikurse janë të përshkruara tutje në këtë shënim.

Këto pasqyra janë përgatitur nën pohimin se Kompania do të vazhdojë vijueshmërinë e saj së paku në 12 muajt e ardhshëm. Operacionet e Kompanisë janë të varura dhe të mbështetura nga grante me fonde të ndryshme. Menaxhmenti i konsideron vlarëson fondet e jashtme që do të jenë të mundshme në të ardhmen të cilat do ti mundësojnë kompanisë investime kapitale.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, SNK-të dhe SNRF-të si dhe dispozitave ligjore kombëtare, kërkon nga menaxhmenti të bëjë vlerësimet dhe parashikimet të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të aseteve dhe detyrimeve dhe shpalosjet e pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrës financiare dhe shumat e raportuara të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së raportuar. Këto vlerësime janë bazuar në informatat e disponueshme në datën e pasqyrave financiare. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021.

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në valutën Euro. dhe janë të përgatitura në pajtueshmëri me rregullën e kostos historike, por njëkohësisht e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e tyre. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe nëse nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar.

Përgaditja e pasqyrave financiare konform rregullave kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Githashtu këkohet nga menaxhmenti ushtrimi i gjykimit profesional në proceset e aplikimit të politikave kontabël. Periudha raportuese e biznesit përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 Dhjetor të vitit.

2.3.Prona, impiantet dhe paisjet

Vlera e pronës , impianteve dhe pajisjeve të Sh.A.- Kompania Regionale e Ujit "Bifurkacioni" me 01.01.2021 janë bartur sipas kostos minus zhvlersimi i akumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes si dhe kostot e mirëmbajtjes kapitale.

Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga bilanci i gjendjes kur shitet ose kur tërhiqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.

Riparimet dhe mirëmbajtja operuese ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ndodhin shpenzimet. Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk zhvlerësohet. Shpenzimet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo janë njohur si asete të ndara, në mënyrën e duhur, vetëm atëherë kur përfitimimi

ekonomik i mundshëm lidhur me to mund të rrjedhë në kompani dhe vlera e mjetit mund të matet seriozisht. Shkalla e zhvlerësimit të aseteve, në harmoni me jetën e përdorimit nuk dallon nga shkalla e zhvlerësimit sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi:

E gjithë prona, impiantet dhe paisjet tjera janë paraqitur sipas koston zbritur për zhvlerësimin e akumuluar. Kosto paraqet shpenzimet që i atribuohen direkt përvetësimit të njësive (zërave).

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të aseteve apo janë njohur si asete te veçanta, siç ka qenë më e përshtatshme, vetëm atëherë kur përfitime ekonomike të mundshme lidhur më këtë mund të rrjedhin në kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha kostot tjera për riparime dhe mirëmbajtje ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Humbjet nga dëmet janë njohur në shumën për të cilën vlera bartëse e asetit e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Vlerë e rikuperimit merret me e larta e vlerës fer të shitjes së atij aseti minus kosto për shitjen apo vlera e koston historike. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë janë të grupuara në nivelin më të ulët prej nga janë identifikuar ndaras rrjedhat e parasë (gjenerimi i njësive të parasë). Pasuritë jo financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar për mundësinë e rikthimit të dëmeve në secilën datë raportimi.

2.4. Zhvlerësimi i aseteve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shumica bartëse e një aseti nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një aseti e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihet në të ardhura. Vlera e rikuperueshme e një aseti është çmimi më i lartë shitës neto i një aseti dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shumica e arritshme nga shitja e një aseti në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë për të ardhmen e flukseve të parasë që pritet të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një aseti dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojë të ardhura.

2.5. Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga shtuarët e licencuar për kompjuter. Këto fillimisht deklarohen sipas koston së tyre dhe më pas sipas koston minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare përderisa kostoja e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjat kohëgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

2.6. Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga aseti financiar skadon, ose kur aseti financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus koston e transaksioneve, me përjashtim të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

2.7. Kreditë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë pasuri/detyrime financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Këto përfshihen në pasuri/detyrime qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e bilancit të gjendjes. Kreditë dhe të arkëtueshmet e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes përbëhen nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

2.8. Stoqet

Stoqet e Kompanisë Regjonale të Ujit "Bifurkacioni" Sh.A. janë kryesisht rezerva të mallit të lidhura kryesisht me funksionimin e kompanisë. Gjendja e stoqeve është vlersuar me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshinë shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre.

2.9. Kapitali i Pronarit

Kapitali i Pronarit fillimisht është njohur në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionarët e kompanisë. Rezervat paraqesin ndryshimet ndërmjet kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës neto të aseteve të transferuara nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit me marrëveshjen e datës 31 Janar 2006.

2.10. Përfitimet e punëtorëve

Numri i të punësuarve në "Kompania Rajonale e Ujit "Bifurkacioni" Sh.A. në raportimin e muajit dhjetor 2021 ka qenë 201 Në rrjedhat normale të biznesit, entiteti bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale, të cilat janë të kalkuluara në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrës së të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

Kompania kontribuon për punëtorët e saj në planet pas pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni i sigurimit shoqëror miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Kontributet, bazuar në paga, bëhen tek Trust i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve. Kompania nuk ka beneficione pas pensionimi për punëtorët e tyre.

2.11. Tatimi

Shoqëria Aksionare Kompani Rajonale e Ujit "Bifurkacioni" kërkohet që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabël, bazuar në metodën e të ardhurave reale apo përllogaritjen e tatimit të realizuar nga periudha e kaluar të rritur me 10% varësisht nga politikat e saj kontabël në përputhshmëri me ligjet e rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar. Biznesi ka paguar tatimin mbi vlerën e shtuar, ka paguar tatimin dhe kontributet në të ardhura personale. Pozicioni i tatimeve dhe kontributeve të pagueshme në bilancin e gjendjes është si rezultat i periudhës së fundit. Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit në të ardhura mund të barten për tu vendosur në pesë vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja.

Tatimi në fitim rrjedhës kalkullohet në bazë të ligjit për tatime në fuqi deri në datën e bilancit të gjendjes. Tatimi në fitim i shtyrë është parashikuar në tërësi, duke përdorur metodën e detyrimeve, në

arritjen e diferencave të përkohshme në mes të bazës së taksave të pasurisë dhe detyrimeve dhe vlerën bartëse të tyre për qëllime të prezantimit në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë përcaktohet duke përdorur normën e tatimit që është në fuqi deri në datën e bilancit të gjendjes dhe pritet të aplikohet kur pasuria prej tatimit të shtyrë të realizohet apo detyrimi i tatimi të shtyrë është përcaktuar

2.12. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat e kompanisë janë kryesisht mjete të cilat realizohen nga veprimtaria primare e entitetit, faturimi i ujit dhe shërbimeve në baza komerciale, dhe njihen në momentin e faturimit.

Të ardhurat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të kompanisë dhe kur shuma e të ardhurave mund të matet besueshëm, si dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kriteret të njohjes së aktiviteteve specifike janë të bazuara në shërbimet ose zgjidhjet e siguruara ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë. Nëse lind ndonjë rrethanë që mund të ndryshojnë vlerësimin origjinal të ardhurave, kostove ose shkallën e progresit drejt realizimit, vlerësimet korrigojnë. Këto rishikime mund të rezultojnë në rritje apo zvogëlime në të ardhurat ose shpenzimet e vlerësuara dhe pasqyrohen në të ardhura në periudhën në të cilën rrethanat që shkaktuan inicimin e rishikimit bëhet i njohur nga menaxhmenti.

2.13. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit apo në datën e faturimit. Shpenzimet njihen sipas parimit akrual, në momentin e ndodhjes. Notat debitore dhe kreditore të lejuara dhe të pranuar njihen si të ardhura- shpenzime operuese.

2.14. Provizionet, detyrimet dhe pasuritë kontingjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluarën, mund të çojnë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shuma e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara. Provizionet nuk njihen për humbjet operative në të ardhmen. Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë lidhur me detyrimin e tanishëm. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale. Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Si pasuritë edhe detyrimet kontingjente shpalosen. Shuma e humbjeve kontingjente njihet si provizion nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme ta konfirmojnë, atë detyrim të shfaqur në bilancin e gjendjes dhe parashikim i arsyeshëm i humbjes që mund të ndodhë. Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Pasuritë qarkulluese të prezantuara si llogari të arketueshme, pjesa më e madhe nuk do duhej të fugurojnë si LL/A.

Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet. Në Sh.A. Kompania Regjionale e Ujit "Biturkacioni" nuk kemi momente kontingjente për periudhën e audituar dhe periudhat e mëparshme. Kompania nuk ka njohur ndonjë shpenzim detyrim të provizioneve për rastet gjyqësore pasi që nuk kishim informata të sakta mbi detyrimin e mundshëm.

3. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR DHE KAPITAL

Rreziku financiar dhe kapital i kompanisë drejtohet nga menaxhmenti ekzekutiv dhe pronarët e kompanisë. Objektivat e kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që biznesi të vazhdojë me punë në të ardhmen.

3.1. Rreziku kreditor

Mjetet financiare të cilat e vënë kompaninë në rrezik kreditor përbëhen prej parasë në dorë dhe parasë në llogaritë bankare. Paraja dhe ekuivalentët e parasë të kompanisë përbëhen kryesisht nga saldot bankare. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit.

3.2. Rreziku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë identifikohen vazhdimisht. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo ndonjë mungesë. Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vërtetim. Kompania mban para për të përmbushur kërkesat e likuiditetit minimum për periudhën 30-ditore. Financimi i nevojave për likuiditet afatgjatë është një sigurim shtesë nga një shumë e mjaftueshme e mundësisë së burimit të zotuar të mjeteve.

3.3. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të kapitalit

Objektivat e kompanisë për menaxhimin e kapitalit janë për të ruajtur aftësinë e biznesit që të vazhdojë aktivitetin mbi parimin e vazhdimësisë në mënyrë që të sigurojë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të zvogëluar koston.

3.4. Pasuritë dhe detyrimet

Vlerat bartëse të aseteve dhe detyrimeve financiare të kompanisë të njohura në datën e bilancit të gjendjes të periudhës raportuese nën vështrim gjithashtu mund të kategorizohet. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të përmbledhura si më poshtë:

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

- Paraja në arkë.....	0.00
- Paraja në bankë- BPB- 1304001001359309.....	382,508.66
- Paraja në bankë- BPB- 1304001001359308.....	5,251.10
- Paraja në bankë- BPB- 1304001001359363.....	3,196.18
- Paraja në bankë- NLB- 1703001011243350.....	38,595.79
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>429,551.73</u>

Pasuritë qarkulluese dhe kërkesat tjera

- Stoqet ne fund të periudhës.....	243,193.00
- Llogarite e arkëtueshme nga klientet.....	8,715,558.46
- Llogarite tjera te arkëtueshme.....	252,118.66
- Parapagimet.....	2,339.00
- Borgjet e ngrira- te dyshimta.....	(2,989,579.00)
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>6,223,630.12</u>

Pasuritë afatgjata materiale

Në Tabelën e mëposhtme i kemi në formë sintetike, të gjitha kategoritë e mjeteve themelore me shtim gjatë vitit 2021 si dhe shpenzimet e zhvlerësimit.

Pasuria

Përshkrimi	Kosto historike	Blerjet 2021	Kosto historike + blerjet 2021	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi 2021	Zhvlerësimi i akumuluar deri 31.12.2021	Pasuria neto 31-12-20	Pasuria neto 31-12-21
Toka	580,400	0	580,400	0	0	0	580,400	580,400
Automjete	252,173.16	1,150	253,323.16	-228,220.46	-11,599.50	-239,819.96	23,952.70	13,503.20
Donacione qeveri	2,554,932.19	0	2,554,932.19	-1,073,982.50	-125,579.76	-1,199,562.26	1,480,949.69	1,355,369.93
Donacione zvicër	3,808,758.64	0	3,808,758.64	-2,253,968.78	-188,956.64	-2,442,925.42	1,554,789.87	1,365,833.23
Inventar	30,269.20	825.2	31,079.40	-23,179.94	-1,899.39	-25,079.33	7,089.26	6,015.07
Rrjeti kanalizimit	2,335,962.55	-	2,335,962.55	(1,542,089.28)	(197,839.16)	(1,739,928.44)	793,873.27	596,034.11
Objekte ndërtimore	1,556,697.65	274.07	1,556,971.72	-1,034,908.11	-77,456.45	-1,112,364.56	521,789.54	444,607.16
Paisje kompjuterike	89,168.01	1,429.92	90,597.93	-81,271.64	-5,270.76	-86,542.40	7,896.37	4,055.53
Paisje të punës	296,221.33	830.51	297,051.84	-293,466.39	-902.63	-294,369.02	2,754.94	2,682.82
Paisje elektrike	115,626.76	1,236.15	116,862.91	-111,998.51	-1,479.71	-113,478.22	3,628.26	3,384.70
Pompa	118,757.13	3,063.95	121,821.08	-97,651.82	-13,824.79	-111,476.61	21,105.31	10,344.47
Rrjet i ujësjellësit	6,597,406.60	83.90	6,597,490.50	-4,459,878.78	-498,585.66	-4,958,464.44	2,137,527.82	1,639,026.06
Total	18,336,373.22	8,893.70	18,345,251.92	-11,200,616.19	-1,123,394.45	-12,324,010.64	7,135,757.03	6,021,256.28

Detyrimet afatshkurta

- Llogarite e pagueshme.....	48,341.00
- Tatimet e pagueshme.....	16,539.00
- Detyrimet tjera afatshkurta-kontribute.....	27,654.00
<u>Gjithsej detyrime afatshkurta.....</u>	<u>92,534.00</u>

Llogaritë e pagueshme janë njohur si obligime si rezultat i veprimeve ekonomike. Detyrimet tregtare dhe shumat tjera të pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për tu paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar

Detyrimet afatshkurtra përmbajnë edhe zërin kontabël tatime tjera të pagueshme, në shumën prej 27,653.79 €, në kuadër të cilit janë përfshirë lloje të ndryshme të detyrimeve, të cilat janë si në vijim:

Tatimi prezentohet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 03/L-162” Mbi Tatimin në të ardhurat e Korporatave” Shpenzimet e tatimit për periushën përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë, njihet me fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohura direkt në kapital ose në të hyra tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferencat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatueshëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen dhe. Vlera kontabel neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë të raportimit për të pasqyruar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme në të ardhmen.

Pasqyrat e prezantuara në ATK ndryshojnë vetëm për shpenzimet e zhvlerësimit, nga kontrolla e vitit 2019 të cilën e kemi pasur nga ATK neve na është ndryshuar shpenzimi i zhvlerësimit, si pasojë e mos njohjes së rivlerësimit të aseteve në vitin 2008, duke na i ulur shpenzimet e zhvlerësimit vetëm për pjesën e rivlerësimit.

Sipas rrjedhës së pasqyrës së të ardhurave sipas ATK shpenzimet e tatimit në fitim i kemi 47,563 uro të cilat janë si rrjedhojë e të hyrave minus shpenzimet e përgjithshme.

Kësti i fundit në vlerë prej 10,341.34 euro është paguar më 17.01.2022, ndërsa diferenca prej 6,137.13 euro do të paguhet para dates 31.03.2022.

Detyrimet afatgjata

- Detyrimet tjera afatgjata.....	3,035,739.55
- Detyrime afatgjata për grante.....	44,441.81
- Shpenzimet nga granti (të hyrat).....	(316,660.18)
<u>Gjithsej detyrime afatgjata.....</u>	<u>2,763,520.96</u>

Kapitali askionar përbëhet nga vlera reale monetare e evidentuar dhe kontribuar nga aksionarët e kompanisë. Në bazë të statutit të ndërmarrjes me rastin e themelimit të KRU Bifurkacioni ka të paraqitura aksione në vlerë prej 25,000.00 euro.

Korigjimi i grantit të shtyrë:

Grandet janë të regjistruara në pasqyrën e Bilancit të Gjendjës si detyrime të shtyera dhe për amortizimin e tyre përdoret metoda sipas jetëgjatësisë dhe pjesa që i takon vitit 2021 njihet edhe në Pasqyrën e të ardhurave si të hyra nga Donacioni-Grandi, në proporcion me shpenzimet e zhvlerësimit.

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme se grantet do të mirren dhe kompania do ti përmbush kushtet e bashkangjitura. Grantet qeveritare lidhur me blerjen e paisjeve, pronës dhe impianteve janë të përfshira në detyrimet jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyrë dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në bazë drejtëvizore sipas shkallës së zhvlerësimit për kategorinë e caktuar.

Grantet qeveritare që lidhen me shpenzimet janë të shtyra dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave gjatë periudhës së nevojshme që të përputhen ato me shpenzimet që ato kanë për qëllim për ti kompensuar.

Shuma prej 44,441.81 euro rrjedh nga rregullimi i aseteve në depo, si pasoj e disa artikujve të cilët kanë mbetur në depo në KRU BIFURKACIONI që nga projekti i CDI. Shuma totale sipas çmimit të tregut arrinë vlerën 44,441.81 euro.

4. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE TË KONTABILITETIT

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të kompanisë, të cilat janë përshkruar në Shënimin 2, menaxhmenti kërkohet të bëj gjykime, vlerësime dhe supozime lidhur me shumën bartëse të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë paraqitur nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura bazohen në eksperiencën historike dhe faktorëve të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishme për këtë qëllim. Vlerësimet dhe supozimet janë shqyrtuar në një bazë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve të kontabilitetit njihet për periudhën të cilën vlerësimi është bërë, nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon si në periudhën e tanishme.

4.1. Vlerësimi i pasigurisë

Kurdo që shumën bartëse e një aseti ose një njësi gjeneruese e tejkalon shumën e rikuperueshme të tij, një humbje nga rënia e vlerës duhet njohur. Kur përcaktohet shumën e rikuperueshme, menaxhmenti vlerëson pritjet e flukseve të parasë nga secila njësi gjeneruese-parash dhe përcakton normën e interesit për llogaritjen e vlerës aktuale të rrjedhjes së parasë.

Menaxhmenti rishikon jetën e dobishme të aseteve të zhvlerësueshme në çdo datë të raportimit. Më 31 Dhjetor 2021, menaxhmenti vlerëson se jeta e dobishme përfaqëson pritjet e përfitimeve nga asetet për kompaninë. Shumën bartëse janë analizuar, megjithatë, mund të ndryshojnë për shkak të vjetërimit teknik. Stoqet maten në koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Në vlerësimin e shumave neto të realizueshme, dëshmitë më të besueshme, të dhënat në dispozicion në kohën e bërë merren parasysh.

5. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria primare nga klientët public dhe të ardhurat nga klientet privat si dhe të ardhurat nga veprimtaria sekondare janë vlera kryesore e shërbimeve të cilat ofron kompania. Shoqëria Aksionare Kompania Rajonale e Ujit "Bifurkacioni" gjatë kësaj periudhe ka realizuar shitje dhe ka realizuar të ardhura si më poshtë:

Te ardhurat nga shtjet dhe te atrdhura tjera

- Të ardhura nga uji.....	1,311,264.29
- Të ardhura nga kanalizimi.....	378,468.95
- Të ardhura nga tarifa fixe.....	436,424.16
- Te ardhurat nga borgjet e vjetra.....	21,771.48
- Te ardhurat nga grantet.....	316,660.40
- Te ardhurat nga shërbimet tjera.....	56,038.34
Gjithsej:.....	<u>2,520,627.62</u>

6. KOSTO E SHËRBIMEVE TË OFRUARA

Kosto e shërbimeve të ofruara në ndërmarrjen Kompania Regjionale e Ujit "Bifurkacioni" gjatë periudhës raportuese 2021 kanë qenë shpenzimet operuese si dhe kostot e personelit të cilat do ti prezantojmë më poshtë:

Kostoja e shërbimit- shpenzimet operuese

- Paga bruto.....	1,025,112.29
- Kontributi i punedhënesit.....	55,753.13
- Qiraja bruto.....	18,969.94
- Shpenzimet e ushqimit.....	89,009.80
- Shpenzimet e karburantit.....	17,966.18
- Shpenzimet e energjisë elektrike.....	158,140.26
- Shpenzimet e mirmbajtjes së rrjetit.....	21,878.78
- Shpenzimet mirembajtjes së automjeteve-makinerise.....	10,930.01
- Shpenzimet e zhvlerësimit.....	864,863.35
- Shpenzimet për sigurim të automjeteve.....	8,996.46
- Shpenzimet e telefonit- internetit.....	2,748.58
- Shpenzimet e licenses dhe anetaresise.....	24,012.60
- Shpenzimet e provizionit bankar.....	5,777.14
- Shpenzimet tjera operuese.....	38,779.53
<u>Gjithsej:.....</u>	<u>2,342,938.05</u>

7. ZOTIMET DHE KONTINGJENTET

7.1.Procedimet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2021, kompania nuk ka ndonjë provizion të regjistruar për humbjet potenciale, sa i përket procedimeve gjyqësore. Menaxhmenti i kompanisë, vazhdimisht analizon rrezikun potencial që rezulton nga humbja lidhur me procedime gjyqësore, dhe pretendimet e mundshme kundër kompanisë, që mund të ngritën në të ardhmen. Ndonëse përfundimi i këtyre çështjeve nuk mund gjithmonë të pohohet me precizitet, menaxhmenti i kompanisë beson që nuk ka mundësi të rezultojë ndonjë detyrim material. Kompania nuk ka njohur ndonjë shpenzim detyrim të provizioneve për rastet gjyqësore pasi që nuk kishim informata të sakta mbi detyrimin e mundshëm.

7.2.Zotimet kapitale

Nuk ka ndonjë zotim kapital domethënës të kontraktuar në datën e bilancit të gjendjes që tani më nuk është njohur në pasqyrat financiare.

8. NGJARJET PASUESE

Pas 31 Dhjetorit 2021 dhe data raportuese deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje të përshtatjes të reflektuar në pasqyrat financiare apo ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për shpalosje në këto pasqyra financiare.

9. PËRBUSHJA E PARIMIT TË VIJIMSISË

Nga pasqyrat financiare duke u bazuar në analiza dhe duke bërë teste përmes koeficientëve financiar si dhe rrjedhat tjera si në biznesin i cili është objekt auditimi mund të konstatojmë se biznesi mund të operoj edhe në periudhat e ardhshme duke plotësuar parimin e vijimësisë.

Sipas standardeve të kontabilitetit, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në lëmin e financave si dhe rregulloret dhe ligjet në lëmin e tatimeve, tregojnë se biznesi është në vazhdimësi të afarizmit dhe kryerjes së obligimeve. Jemi të mendimit se biznesi do të vazhdoj me afarizmin e vet edhe në të ardhmen. Pasuritë e destinuar për aktivitet dhe shërbimet e kompanisë janë në trend normal me rrjedhat në degën ku operon kompania, dhe jemi të mendimit se kanë gjasa reale të vazhdojnë me operime. Gjithashtu jemi të mendimit se pasuritë e blera me qëllim të përdorimit dhe zhvillimit të veprimtarisë siç janë pajisjet dhe makineritë e nevojshme do të përdoren gjatë tërë kohës së paraparë për përdorim. Jemi të mendimit në bazë të dhënave nga pasqyrat financiare se detyrimet kompania ka mundësi ti kryej normalisht dhe në vazhdimësi. Këto fakte dhe dëshmi japin mundësi për të vazhduar ekzistencën për një periudhë të arsyeshme kohore me pretendime të qarta për kapacitete stabile operuese dhe kapitalit. Kjo gjithashtu shihet dhe është në përputhje me planet strategjike të kompanisë. Treguesit e rrjedhave fizike dhe financiare për këtë vit japin rezultate të cilat premtojnë. Shihet nga pasqyrat dhe raportet e punës se për vitin 2021 janë realizuar të ardhura në nivel të vitit paraprak. Nëse bëjmë një analizë përmes koeficientëve financiar, si koeficientët e likuiditetit, efikasitetit dhe rentabilitetit mund të konstatojmë se kompania në këtë periudhë reflekton tregues të arsyeshem.

Likuiditeti:

- Koeficienti vijues shënon rezultat shumë inkurajues, ngase pasuritë qarkulluese kalojnë dukshëm detyrimet qarkulluese në këtë vit. Sipas këtij koeficienti kompania do të duhej të mbulonte çdo euro të detyrimeve qarkulluese me pasuri qarkulluese, të cilin kusht e përmbush për disa herë.
- Koeficienti i shpejtësisë ku vihen në raport para e gatshme dhe llogaritë e arkëtueshme, me detyrimet qarkulluese, ishte poashtu ideal. Ky koeficient është ideal ngase para e gatshme dhe llogaritë e arkëtueshme kalojnë detyrimet qarkulluese më shumë herë, dhe kompania nuk ka pasur nevoj të mendoj që përmes shitjes së detyrueshme të pasurive dhe heqjes dorë nga rezervat, ti paguaj faturat për borxhe nga fakti se detyrimet janë kryer me sukses nga aktivitetet operuese.

Efikasiteti:

- Koeficienti, ditët në llogari të arkëtueshme ku vihen në krahasim llogaritë e arkëtueshme me gjithsej shitjet ku del se mesatarja e llogarive të arkëtueshme gjatë vitit 2021 ishte 407,85 ditë. Kur analizohet gjendja e LL/A në kompani mund të konstatojmë se ky koeficient ishte i pritshëm. Këta koeficient ndryshe quhen edhe koeficientët e menaxhimit të pasurisë dhe tregojnë se me çfarë efikasiteti kompania menaxhon pasuritë. Nga rezultati i këtij koeficienti shihet qarte se kompania i ka menaxhuar keq LL/A.

Rentabiliteti:

- Koeficienti, diferenca në fitim bruto ku vihet në raport fitimi bruto me shitjet totale nuk ishte i aplikueshem pasi që kompania nuk i ka ndare kostot direkte dhe shpenzimet tjera operuese.
- Koeficienti, kthimi në kapital ku vihen në krahasim fitimi neto me kapitalin e pronarëve nuk rezulton i mirë krahasuar me nivelin e qarkullimit dhe shpenzimeve evidente operuese, sidomos atyre të zhvlerësimit. Një nivel i kthimit prej 1.2% në vitin 2021 është teorikisht i pamjaftueshem. Këtë koeficient më tepër kompania duhet ta shfrytëzoj për analiza krahasuese me degët tjera.

Bazuar në dëshmitë të cilat mbështesin pasqyrat financiare si dhe procedurat e kryera, jemi të mendimit se mundësitë e plotësimi të parimit të konsistencës mund të arrihen dhe kompania me këtë trend mund të funksionoj edhe një periudhë reale kohore me mundësi të zgjerimit dhe rritjes së mëtutjeshme.

10. FUSHËVEPRIMI, OBJEKTIVAT DHE SHTRIRJA E AUDITIMIT

Auditimi është përformuar në harmoni me ligje e rregulla të aplikueshme. Standardet e përmendura kërkojnë që ne të planifikojmë dhe ekzekutojmë auditimin në mënyrë që të nxjerret një siguri e arsyeshme se gjendjet e prezentuara në pasqyrat financiare nuk kanë pasur keqpohime materiale apo ndryshime. Auditimi jonë përmbanë hulumtimin e informatave të mbledhura të rëndomta për të vërtetuar shumat dhe informatat e prezentuara në raportin financiar. Po ashtu ky raport përmban hulumtimin dhe mendimin mbi politikat e kontabilitetit të cilat janë aplikuar, duke i dhënë rëndësi të veçant se si janë bërë ato nga menaxhmenti, dhe hulumtimi mbi prezentimin gjeneral të kontove të shoqerisë.

11. SIGURIMI I DËSHMIVE DHE TESTEVE GJATË PROCESIT TË AUDITIMIT

Në Kompanisë Regjionale të Ujit "Bifurkacioni" Sh.A. kemi kryer një sërë testesh përmes mostrave të dëshmimeve autentike. Punën e testimit dhe sigurimit të dëshmimeve e kemi zhvilluar me ndihmën e stafit të entitetit ku do të prezentojmë disa prej dëshmimeve dhe mostrave të zgjedhura nga arkivi i librave të kontabilitetit dhe dokumente tjera që janë shfrytëzuar gjatë auditimit.

- Statuti i entitetit
- Procedurat
- Marrëveshja në mes të entitetit dhe të punësuarëve të rregullt dhe kontraktorëve
- Dokumentet e kontabilitetit të cilat janë subjekt i auditimit
- Pasqyrat financiare dhe të aktiviteteve lidhur me entitetin
- Shpalosjet e pasqyrave financiare
- Çdo dokument tjetër i cili ka të bëjë me entitetin

12. NJOHJA DHE VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE SISTEMIT KONTABËL

- Kemi zgjedhur strategjinë e kombinuar, të besimit (me ndihmën dhe asistencën e stafit), dhe të mosbesimit (testeve të pavarura) në kontrollin e brendshëm. Kemi bërë biseda me nivelin e duhur të menaxhmentit, mbikëqyrësve dhe personelit tjetër, inspektimi i dokumentacionit, raporteve dhe dosjeve elektronike. Po ashtu kemi vëzhguar aplikimin e sistemit të kontroleve të brendshme
- Gjatë procedurave audituese, në bazë të asaj që kemi arritur të shohim, mund të konstatojmë se këtu kontrollohen raportet financiare nga disa nivele duke filluar nga kontabilisti, mbikqyrësit, menaxherët ekzekutiv dhe sipas nevojës dhe materialitetit edhe nga pronari.

13. PËRFUNDIMI

Me kompetencë dhe siguri të arsyeshme mund të konstatojmë, nga pasqyrat financiare dhe shpalosjet e pasqyrave, shihet se ekziston një saktësi e mjaftueshme në regjistrime kontabël dhe evidenca. Nuk kemi arritur të vërejmë ndonjë gabim apo tendencë për ndonjë gabim material apo ndonjë mashtrim. Gjatë sigurimit të dokumentacionit nuk kemi hasur në ndonjë pengesë për ta bërë këtë. Auditimin e kemi planifikuar, dhe programin e auditimit e kemi realizuar sipas dinamikës së paraparë. Ne do të dëshironim të shprehim vlerësimin dhe falënderimin tonë për bashkëpunim dhe asistencë të ofruar nga personeli i kontaktuar i Kompanisë Regjionale të Ujit "Bifurkacioni" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade*

Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë/Kosovska Agencija za Registracije Biznisa/
Kosova Business Registration Agency



**KONFIRMIM I DORËZIMIT TË RAPORTEVE FINANCIARE
CONFIRMATION OF THE FILING OF FINANCIAL REPORTS
POTVRDA O PRIMOPREDAJI FINANCIJSKIH IZVEŠTAJA
VITI RAPORTUES 2021**

Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare që auditohen në pajtim me standardet ndërkombtare të auditimit dhe të Ligjit Nr. 06/L-032 neni 17 e në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 dhe nenin 8 paragrafi 1 dorëzohen në KKRF dhe një kopje në MTI .

Nr.fletëparaqitjes/Application Nr./ Br. Zahteva 24 / 2022
Emri i biznesit/Business name/Ime – **KRU BIFURKACIONI SHA**
Komuna/Municipality/Opština - **FERIZAJ**
Nr. i biznesit/Business ID/ID Biznesa – NUI – **810663353**

Vërejtje : Klasifikimi i Shoqërive Tregtare bëhet sipas nenit 5 i Ligjit Nr.04/L-014.

Data e dorëzimit :

27.04.2022



Zyrtar për të Hyra në ARBK
Salih Krasniqi